



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**

**K.P.P. 126/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |         |
|---------------|---------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar  |
| Lindita Skeja | Anëtar  |
| Merita Zeqaj  | Anëtar  |

Në mbledhjen e datës 18.03.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Kundërshtimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” shpk dhe kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë M.A.K.Studio & “A&E Engineering” shpk në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-82944-12-23-2020, me objekt Loti 3: “*Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor*” me fond limit 68.699.171,42 (gjashtëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një presje dyzetë e dy) lekë pa TVSH.

**Ankimues:** BOE “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” shpk  
Bulevardi Zogu i I, Pallati i ri 12 katësh, Ap.8-3, Pranë Cirkut, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik,

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:****I***Vlerësimi paraprak*

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës.

**II**

## *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.12.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *Shërbim Konsulence*, me Nr.REF-82944-12-23-2020, me objekt Loti 3: *“Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”* me fond limit 68.699.171,42 (gjashtëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një presje dyzetë e dy) lekë pa TVSH.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr. 2071/1 prot datë 01.03.2021, si dhe nga verifikimet në SPE, rezulton se në datën 05.01.2021 autoriteti kontraktor, ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

- HE&SK 11& Magna Charta
- 47EK79&Iliriada pks&Studio Rebus
- Civil Cons
- Gjeokonsult&Co
- M.A.K Studio&A&E Engineering

II.3. Rezulton se në datën 29.01.2021 ka përfunduar procesi i vlerësimit të dokumentacionit të kërkesave për shprehje interesi të paraqitur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës nga KVO dhe janë njoftuar lidhur me kualifikim/skualifikimin e ofertave të tyre si më poshtë:

- |                                    |                |
|------------------------------------|----------------|
| - HE&SK 11& Magna Charta           | I skualifikuar |
| - 47EK79&Iliriada pks&Studio Rebus | I skualifikuar |
| - Civil Cons                       | I skualifikuar |
| - Gjeokonsult&Co                   | I kualifikuar  |
| - M.A.K Studio&A&E Engineering     | I kualifikuar  |

II.4. Në datën 29.01.2021 bashkimi i operatorëve ekonomik “47EK79&Iliriada pks&Studio Rebus” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- *Skualifikohet BOE 47 EK 79 & ILIRIADA P.K.S dhe STUDIO REBUS sepse nuk plotëson kriterin 2.3.1 të dst për përvojën e mëparshme, pasi me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve vlera e tyre, e llogaritur për shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet (të së njëjtës natyrë) gjatë tri viteve të fundit, është më e vogël se 30% e fondit limit të kontratës që prokurohet (20’609’751.43 lek pa TVSH). Në vlerën e llogaritur nuk janë marrë parasysh shërbimet e ngjashme jashtë afatit 3 vjeçar nga data e zhvillimit të tenderit. Gjithashtu nuk janë marrë parasysh*

shërbimet për objekte civile (që nuk janë rrugë apo mirëmbajtje rruge) si dhe nuk janë marrë parasysh objektet të kontratave në vazhdim (nuk konsiderohen të realizuara me sukses gjatë tri viteve të fundit).

- Anëtar i BOE Studio REBUS nuk vërteton se ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajin Nëntor 2020, kjo në kundërshtim me dst ku kërkohet: Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

II.5. Në datën 04.02.2021 operatori ekonomik “47EK79&Iliriada pks&Studio Rebus” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “M.A.K Studio&A&E Engineering” me argumentet si më poshtë:

- Në pikën 2.3.1 kapaciteti teknik përcaktohet kriteri si më poshtë: Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 30% të fondit limit të kontratës që prokurohet, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit. Kjo të vërtetohet me kopje të kontratave/vërtetim të lëshuar nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohet, fatura tatimore e shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.

Pra në DT është e shprehur qartë që vlera e kontratës për punë të ngjashme është shumatore e kontratave për punë të ngjashme dhe jo e një kontratë të vetme. Nëse mbledhen vlerat e kontratave për punë të ngjashme të anëtarëve të BO e tejkalon vlerën e përcaktuar në DT. Shoqëria 47EK79&Iliriada pks sapo ka realizuar shërbimin e mbikëqyrjes me objekt “Shpenzime supervizion i kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve, Rajoni Jugor Gjirokastrë”, pra i njëjti objekt i cili prokurohet dhe vlera e saj (14,360,750.00 lekë pa TVSH), mbulon 70% të vlerës për punë të ngjashme dhe 30% e vlerës për punë të ngjashme plotësohet me kontratat e tjera të ngjashme.

Është jashtë çdo logjike që shoqëria 47EK79&Iliriada pks, sapo ka realizuar Shërbimin e Mbikëqyrjes me objekt “Shpenzime Supervizion i kontratave të mirëmbajtjes së rrugëve, rajoni Jugor Gjirokastrë dhe skualifikohet për kontrata pune të ngjashme, në një kohë që kualifikohet shoqëria Mak Studio shpk ku është shumë e dyshimtë kontrata për punë të ngjashme që ka dorëzuar kjo shoqëri. Ndryshimi në vlerë i kontratës për punë të ngjashme të realizuar me këtë që prokurohet është për shkak të rritjes së afatit të kryerjes së shërbimit nga 2 vjet në 4 vjet. Pra është e njëjta procedure por e dyfishuar për shkak të afatit. Është e palogjikshme që të thuhet që nuk plotësojmë kriterin e kontratave për punë të ngjashme. Shërbimi që kërkohet është i njëjti por i zgjatur me dy vite të tjera pasi objekti që prokurohet është i njëjti. Të skualifikosh të njëjtën

kompani që sapo ka realizuar të njëjtën kontratë “Supervizion mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor” është i padrejtë. Ndërkohë që është kualifikuar shoqëria MAK shpk e cila nuk ka kontratë për punë të ngjashme dhe çdo dokument i dorëzuar nga kjo shoqëri është i dyshimtë që plotëson kriteret e përcaktuara në DT. Bazuar në argumentet e mësipërme dhe në dokumentacionin e dorëzuar nga ana jonë skualifikimi për mosplotësim të kriterit 2.3.1 të DT për përvojë të mëparshme është i padrejtë dhe kërkojmë anulimin e vendimit për skualifikim. Gjithashtu kërkojmë rishikimin e të gjithë dokumentacionit të dorëzuar nga M.A.K Studio pasi është e pamundur që kjo shoqëri të plotësojë kriteret e përcaktuara në DT.

- Pika 2: Në nenin 9 “pagesa dhe afati për kryerjen e saj” paragrafi 9.1 të kontratës së miratuar me vendimin e ERE nr.109 datë 21.10.20211 Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë”. Përcaktohet shprehimisht: Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe ku është rasti kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar. Data e shpalljes së tenderit është 23.12.2020. Pra pas kësaj date operatorit ekonomik i lind e drejta për dorëzimin e dokumentacionit në sistemin elektronik të prokurimeve. Dhe çdo dokument i cili është i vlefshëm deri në këtë datë është i vlefshëm deri në përfundimin e procedurës. Pra vërtetimi i paraqitur nga shoqëria Studio Rebus është i vlefshëm. Skualifikimi është i padrejtë dhe kërkojmë anulimin e vendimit për skualifikim.
- Bazuar në udhëzimin mbi deklarin e konfliktit të interesit nga zyrtarët e prokurimit nr.3 datë 24.10.2016 dhe nenit 21/3 të ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 Për parandalimin e konfliktit të interesit i ndryshuar , neni 30 i KprA, kërkojmë të bëhen verifikime nëse anëtarët e KVO janë në gjendjen e konfliktit të interesit me shoqërinë M.A.K Studio.

II.6. Me shkresën nr.1257/2 prot datë 10.02.2021 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 19.02.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankesë drejtuar autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 2071/1 prot., datë 01.03.2021, protokolluar me tonën me shkresën nr.275/2 datë 03.03.2021 , me objekt “Dërgim informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tyre me arsyetimin se “Anëtar i BOE Studio REBUS nuk vërteton se ka shlyer detyrimet e të energjisë elektrike për muajin Nëntor 2020, kjo në kundërshtim me dst ku kërkohet: Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë

*Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:*

*a. Sigurimin e Ofertës (nese eshte e zbatueshme) sipas Shtojcës 6; (nuk kerkohet)*

*b Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;*

*c. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;*

*ç. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 11/1:*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër anëtar i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Studio - Rebus” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Debie Nr.5207 prot datë 01.12.2020 me anë të së cilës vërtetohet se kërkuesi Studio –Rebus shpk nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit për kontratën me kod TR1B030055153591 titullar i së cilës është Studio –Rebus shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike vlerë e llogaritur deri në datën 01.12.2020, pa përfshirë faturën koherente të muajit Nëntor 2020.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

III.1.4 Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.5. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve”, pika 4, gërma “ç” të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet : *[...]Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”*

III.1.6. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.1.7. KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Referuar sa më sipër nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se anëtar i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rebus” shpk ka dorëzuar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve të energjisë elektrike pa përfshirë detyrimet e maturuara të muajit Nëntor 2020. Nga verifikimet në SPE, rezulton se në datën 05.01.2021 autoriteti kontraktor, ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit). Referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi datë 05.01.2021, KPP gjykon se detyrimet e energjisë elektrike për muajin Nëntor 2020 janë tashmë të maturuara në kuptim të përcaktimeve

ligjore sa më sipër dhe afati i fundit për shlyerjen e tyre ka qenë data 31.12.2020. Në këtë kuptim referuar datës së zhvillimit të fazës së parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi (05.01.2021), Komisioni gjykon se, anëtari i bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rebus” shpk, nuk ka plotësuar kriterin e veçante të kualifikimit lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet në dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i BOE “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet mbi arsyen tjetër të skualifikimit të BOE “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar gjykimit më sipër gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të vijojë të ngelet e skualifikuar edhe pas ankimit në KPP, duke mos pasur më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

III.3. Lidhur me pretendimet e BOE “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” mbi skualifikimin e M.A.K Studio shpk, me pretendimet se *“Bazuar në udhëzimin mbi deklarinimin e konfliktit të interesit nga zyrtarët e prokurimit nr.3 datë 24.10.2016 dhe nenit 21/3 të ligjit nr.9367 datë 07.04.2005 Për parandalimin e konfliktit të interesit i ndryshuar, neni 30 i KprA, kërkojmë të bëhen verifikime nëse anëtarët e KVO janë në gjendjen e konfliktit të interesit me shoqërinë M.A.K Studio”*. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtrohet fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me konfliktin e interesit që mund të ekzistojë ndërmjet anëtarëve të KVO-së dhe shoqërisë M.A.K Studio shpk.

III.3.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe *“elementet e domosdoshëm të ankesës”* sipas përcaktimeve të nenit 20, *“Forma dhe përmbajtja e ankesës”*, pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”*.

III.3.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente konkretë ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra,



KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të hetojë dhe verifikojë në themel lidhur me një pretendim abstrakt i cili nuk ka referuar në asnjë shkelje konkrete, person konkret apo situatë ligjore konkrete për të vërtetuar gjendjen e konfliktit të interesit të supozuar, që mund të ekzistojë midis anëtarëve të KVO-së dhe shoqërisë M.A.K Studio shpk.

III.3.4. Ligji Nr.9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar në nenin 5 të tij “Interesat private”, parashikon shprehimisht se:

1. *Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga:*

*a) të drejta dhe detyrime pasurore të çdolloj natyre;*

*b) çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile;*

*c) dhurata, premtime, favore, trajtime preferenciale;*

*ç) negocime të mundshme për punësim në të ardhmen nga ana e zyrtarit gjatë ushtrimit të funksionit apo negocime për çdolloj forme tjetër marrëdhëniesh me interes privat për zyrtarin, pas lënies së detyrës, të kryer nga ai gjatë ushtrimit të detyrës;*

*d) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie, që krijon të ardhura, si dhe angazhime në organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse, sindikata ose organizata profesionale, politike, shtetërore dhe çdo organizatë tjetër;*

*dh) marrëdhënie: i) familjare apo të bashkëjetesës; ii) të komunitetit; iii) etnike; iv) fetare; v) të njohura të miqësisë apo të armiqësisë;*

*e) angazhime të mëparshme, nga të cilat kanë buruar ose burojnë interesa të përmendur në shkronjat e mësipërme të këtij neni.*

2. *Kufizimet e interesave privatë, të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat, të përcaktuara shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit, që zbatohet ai kufizim që është më i rreptë.*

3. *Nëse në këtë ligj, në lidhje me një interes të caktuar privat të një zyrtari, nuk është përcaktuar ndonjë kufi sasior i kufizimit të këtij interesi, ndërsa në një ligj tjetër i njëjti interes, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesave, kufizohet shprehimisht sipas një kufiri sasior, atëherë ky kufizim zbatohet edhe për këtë ligj dhe anasjelltas*

4. *Vlerësohet shkak për lindjen e konfliktit të interesit, çdolloj interesi privat i një zyrtari nga ata të përcaktuar në këtë nen, çdo lidhje apo gërshetim ndërmjet dy a më shumë prej tyre, nëse për shkak të këtij interesi ose për shkak të daljes jashtë kufizimeve të detyrueshme të këtij interesi, shfaqet një gjendje me konflikt interesi, sipas përkufizimeve të pikave 1 e 4 të nenit 3 të këtij ligji.*

Neni 6 i ligjit të sipërcituar parashikon shprehimisht se: *Me zgjedhjen ose emërimin e tij e në vazhdim, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë, sa më parë dhe në mënyrën më të frytshme të mundshme, çdo gjendje të konfliktit të tij të interesit. Në rast se zyrtari nuk është i bindur për ekzistencën apo jo të një konflikti interesi të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me eprorët. 2. Çdo epror dhe institucion epror duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur rastet e konfliktit të interesit.*

Neni 7: *Çdo zyrtar, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarim paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi. 2. Deklarimi rast për rast i interesave privatë bëhet çdo herë nga zyrtari, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni epror. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi mund të kërkohet dhe të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur. 3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë bëhet si rregull me shkrim, kur zyrtari përfshihet në një vendimmarrje për një akt. Deklarimi me shkrim nuk është i domosdoshëm kur deklaramet verbale të zyrtarit janë të regjistrueshme dhe të dokumentueshme, sipas procedurave të përcaktuara me ligj dhe/ose në rregulloret e brendshme të institucionit publik, ku zyrtari ushtron funksionet e veta. 4. Deklarimi i interesit për rastet e përcaktuara në shkronjën “dh”, “iii”, “iv” dhe “v” të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, si dhe përkatësia në organizata politike në kuptim të shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji bëhet vetëm me vullnetin e lirë të zyrtarit.*

Neni 8: *Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit, është: a) detyrë e çdo zyrtari tjetër që ka dijeni, në veçanti e eprorit të tij; b) detyrë e çdo institucioni publik, që ka dijeni; c) e drejtë e palëve të interesuara, që preken nga veprimet e zyrtarit; ç) e drejtë e çdo personi, i cili ka dijeni dhe që ka një interes në përgjithësi e që përputhet me qëllimin e këtij ligji.*

Neni 9: *Burime të tjera informacioni për interesat privatë të një zyrtari mund të jenë edhe: a) regjistrat publikë ose privatë, të mbajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të dhënat nga media; c) të dhënat ose ankesat nga publiku; ç) çdo burim tjetër i ligjshëm*

III.3.5. Referuar parashikimeve ligjore sa më sipër, KPP vëren se gjendja e konfliktit të interesit kërkon plotësimin e disa kushteve dhe elementëve për të cilat referuar parashtrimeve në ankesë rezulton se nuk është bërë asnjë referim konkret. Në parashtrimet në ankesë kërkohet në mënyrë të përgjithshme të kryhet një hetim i gjithanshëm lidhur me mundësinë e ekzistencës së konfliktit të interesit midis njërit nga pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit objekt ankimi dhe anëtarëve të KVO-së. Ky pretendim nuk mbështet në asnjë provë dhe indicie konkrete por vetëm mbi citimin e dispozitave ligjore që rregullojnë fushën e konfliktit të interesave të zyrtarëve publikë. Gjithashtu bashkëlidhur ankesës rezultojnë të jenë paraqitur baza ligjore që ankimesi ka cituar në ankesë dhe asnjë provë konkrete tjetër mbi të cilin ai mbështet pretendimin e tij.

Së pari: deklarimi i konfliktit të interesit është i detyrueshëm të bëhet nga zyrtari i cili e gjen veten përballë një situatë të tillë me anë të një vetëdeklarimi paraprak. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar për procedurën objekt shqyrtimi, KPP vëren se anëtarët e

KVO –së kanë plotësuar vetëdeklarimet e tyre në të cilat shprehen se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Së dyti: Sipas nenit 8 “*Ofrimi i informacionit, për interesat privatë të zyrtarit*”, është ndër të tjera edhe e drejtë e palëve të interesuara, që preken nga veprimet e zyrtarit, por në rastin konkret referuar parashtrimeve në ankesë, pala që pretendon të jetë cënuar në këtë proces nuk ka raportuar një gjendje konkrete se ku konsiston konflikti i interesit qoftë ky në dukje apo një konflikt interesi i mundshëm, dhe midis kujt ekziston një gjendje e tillë. Ankimuesi në mënyrë hipotetike citon të gjithë bazën ligjore që rregullojnë fushën e konfliktit të interesit pa pretenduar një gjendje konkrete por një situatë të përgjithshme midis të gjithë anëtarëve të KVO-së dhe shoqërisë M.A.K Studio çka e bën të paidentifikueshme dhe të paqartë pretendimin e tij dhe të pambështetur në asnjë argument bindës. KPP gjykon se operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij dhe të ngrejë pretendime konkrete dhe jo të përgjithshme sikundër në rastin konkret.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.3.7. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret të shkeljes nga ana e autoritetit kontraktor, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës*

*për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se *“onus probandi incumbit actori”* se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, neni 21 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikon se: *“Informacioni i administruar, sipas nenit 12 të këtij ligji, i vihet në dispozicion çdo personi të interesuar, palë në proces, me kërkesë të tij, pasi ka përfunduar klasifikimi i ofertave. Autoriteti kontraktues është i detyruar ta vërë në dispozicion informacionin brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”,* ndërkohë në nenin 25 të tij parashikohet se *“Pa cënuar dispozitat e këtij ligji mbi detyrimin për botimin e kontratave të prokurimit dhe të informacioneve për kandidatët dhe ofertuesit, sipas neneve 21 e 57 të këtij ligji, autoriteti kontraktor nuk duhet të bëjë publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave”.*

III.3.8 KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “47EK79& ILIRIADA PKS & STUDIO-REBUS” shpk për procedurën e prokurimit, *“Shërbim Konsulence”*, me Nr.REF-82944-12-23-2020, me objekt Loti 3: *“Supervizion Mirëmbajtje me performancë të rrugëve Rajoni Jugor”* me fond limit 68.699.171,42 (gjashtëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një presje dyzetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedures së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 275 Protokoli, Datë 19.02.2021**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**